



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 12 korrik 2012
Nr. ref.: RK /275/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në
Rastin nr. 140/11

Parashtruesi

Habib Ymeri

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Gjykatës Supreme të Kosovës
Rev. 383/2008, të 10 qershorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan Gjyqtar
Altay Suroy, Gjyqtar
Almiro Rodrigues, Gjyqtar
Snezhana Botusharova, Gjyqtare dhe
Ivan Čukalović, Gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi është Habib Ymeri banor i Gjilanit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. 383/2008, të 10 qershorit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 1 korrik 2011.

Objekti i çështjes

3. Më 27 tetor 2011 parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) me pretendim se i është shkelur e drejta e tij e garantuar me Nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, Neni 20 i Ligjit dhe, Rregulli 56 (2) i Rregullores.

Procedura në Gjykatë

5. Më 26 tetor Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 12 janar 2012, Kryetari, me Vendimin nr. GJR. 133/11, e caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë Kryetari, me Vendimin nr. K.SH. 33/11, caktoi Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Almiro Rodriguez (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Kadri Kryeziu.
7. Më 24 janar 2012, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Kosovës. Deri më tani nuk është marrë ndonjë përgjigje. Të njëjtën ditë Gjykatës Komunale të Gjilanit iu dërgua kërkesa për fletëkthesën, për të kuptuar datën e saktë kur parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. 383/2008.
8. Më 8 shkurt 2012, Gjykata Komunale e Gjilanit dërgoi dokumentet e kërkuara, të cilat ofronin dëshmi se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës i është dorëzuar parashtruesit më 1 korrik 2011.
9. Më 11 korrik 2012, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin paraprak të Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhja e fakteve në Procedurën Administrative

10. Në 2001 (nuk është dhënë data e saktë) Parashtruesi krijoi marrëdhënien e punës në Komunën e Gjilanit- Drejtorinë e Urbanizmit, Rindërtimit dhe Ambientit/Spektori i dhënies së lejeve të Komunës së Gjilanit në pozitën Urbanist.
11. Më 14 dhjetor 2004, Drejtori i Sektorit të dhënies së lejeve e bëri vlerësimin e performancës së Parashtruesit.
12. Përveç kësaj, Shefi ekzekutiv i Komunës bëri vlerësimin tjetër të performancës dhe si rrjedhojë e kësaj me Vendimin 02/164 të 28 shkurtit 2005 vendosi që parashtruesit të mos ia përtërijë kontratën e punës.
13. Më 14 mars 2005, Parashtruesi i parashtrroi ankesë Komisionit të ankesave të autoritetit lokal kundër Vendimit 02/164 për mos-përtëritjen e kontratës së punës.
14. Më 13 qershor 2005, Komisioni i ankesave nxori vendimin i cili i hodhi poshtë ankesat e Parashtruesit dhe e miratoi vendimin e Shefit ekzekutiv për përfundimin e marrëdhënies së punës.
15. Më 9 prill 2005, Parashtruesi parashtrroi ankesë në Bordin e Pavarur Mbikëqyrës – Ministria e Shërbimeve Publike me pohimin se janë bërë shkelje serioze të dispozitave procedurale.
16. Më 8 dhjetor 2006, Bordi i Pavarur Mbikëqyrës (në tekstin e mëtejshëm: BPM) nxori vendimin Nr. 02/66/2005 dhe e hodhi poshtë si të pabazë ankesën e Parashtruesit dhe e miratoi Vendimin 02/164 të 28 shkurtit 2005.

Përmbledhja e fakteve në procedurën gjyqësore

17. Parashtruesi i kërkesës i pakënaqur me vendimin e BPM parashtroi padi në Gjykatën Komunale të Gjilanit duke kërkuar shfuqizimin e Vendimit 02/164 të Komunës së Gjilanit për mos-përtëritjen e kontratës, dhe të Vendimit Nr. 02/66/2005 të BPM.
18. Më 10 mars 2008, Gjykata Komunale e Gjilanit nxori Aktgjykimin C. no. 562/07 i cili e miratoi ankesën e parashtruesit dhe e shfuqizoi Vendimin 02/164 të Komunës së Gjilanit për mos-përtëritjen e kontratës dhe, Vendimin Nr. 02/66/2005 të BPM, duke obliguar Komunën e Gjilanit që ta kthejë parashtruesin e kërkesës në vendin e tij të mëparshëm të punës.
19. Komuna e Gjilanit parashtroi ankesë në Gjykatë e Qarkut në Gjilan kundër Aktgjykimit C. no. 562/07 të Gjykatës Komunale, duke kërkuar anulimin e tij.
20. Më 18 qershor 2008, Gjykata e Qarkut nxori Aktgjykimin AC. nr. 172/08, me të cilin vërtetoi Aktgjykimin C. no. 562/07 të Gjykatës Komunale dhe e hodhi poshtë ankesën e Komunës së Gjilanit.
21. Komuna e Gjilanit paraqiti kërkesë për Revizion, si mjet të jashtëzakonshëm, në Gjykatën Supreme të Kosovës.
22. Më 10 qershor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori Aktgjykimin e saj Rev. no. 383/2008, i cili i miratoi pretendimet e Komunës së Gjilanit dhe i ndryshoi aktgjykimet: C. no. 562/07 të Gjykatës Komunale në Gjilan dhe AC. no. 172/08 të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, me konstatimin se:

“Gjykata Supreme e Kosovës e Kosovës vlerëson se meqë kontrata e punësimit të paditësit nuk është përtëritë, marrëdhënia e punësimit të paditësit, si shërbyes civil, është ndërprerë automatikisht në pajtim me Nenin 32.1 (b) të Udhëzimit Administrativ nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores 2001/36 për Shërbyesit Civil të Kosovës”.

Përveç kësaj, Gjykata Supreme e Kosovës jep arsyetimin për ndryshimin e Aktgjykimit të Gjykatës së instancës së ulët:

“Qëndrimi juridik i gjykatave të instancës më të ulët, se nuk është relevant vlerësimi i punës së paditësit, i bërë nga ana e Kryeshefit ekzekutiv të paditurës, sepse i njëjti nuk është menaxher i paditësit e sa mbikëqyrës i punës së tij, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme është i gabuar, pasi që me Udhëzimin Administrativ nr. MSHP/DASHC. 2003/2 për procedurat e kontratave, në pikën 5a- “mos-përtëritja e kontratave” është paraparë se Sekretari i përhershëm /Kryeshefi Ekzekutiv, do të rishqyrtojë dëshmitë dhe do të merr vendim përfundimtar për ndërprerje të kontratës respektivisht për mos-përtëritje të saj.

Pretendimet e parashtruesit

23. Parashtruesi pretendon se me Aktgjykimin Rev. no. 383/2008 Gjykata Supreme ia ka shkelur të drejtën e tij për të punuar të garantuar me Nenin 49 të Kushtetutës. Ai po ashtu pretendon se koha që i është dashur Gjykatës Supreme për të vendosur në rastin e tij ka qenë e paarsyeshme.

Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës

24. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton, se:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me lig”.

25. Nga dokumentacioni i dorëzuar mund të shihet se Parashtruesi i ka shtjerë të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

26. Paragrafi 1 Nenit 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese përcakton, se:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

27. Vendimi më i fundit në lidhje me këtë rast është vendimi i datës 10 qershor 2011, që iu dorëzua parashtruesit më 1 qershor 2011. Parashtruesi paraqiti kërkesën në Gjykatën Kushtetuese më 27 tetor 2011, që do të thotë se ai paraqiti kërkesën në këtë Gjykatë në përputhje me afatin e përcaktuar në Nenin 49.

28. Edhe pse parashtruesi ka shterur të gjitha mjetet juridike për të realizuar të drejtën e tij të supozuar për punë, të paraparë me Kushtetutë, ai nuk ka ofruar ndonjë provë- Fakt relevant për të mbështetur se “autoritetet administrative ose gjyqësore kanë bërë ndonjë shkelje të të drejtave të tij/saj të garantuara me Kushtetutë”, (shih Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ për pranueshmërinë në rastin nr. 53363/99 të datës 31 maj 2005).

29. Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, § 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] e 1999-I).

30. Gjykata Kushtetuese mundet vetëm të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë, dhe nëse procedurat në përgjithësi të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa nr. 13071/87 e miratuar më 10 korrik 1991).

31. Megjithatë, pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura nga parashtruesi Gjykata Kushtetuese nuk ka vëren që procedurat në Gjykatën Supreme ishin të padrejta apo të prekura nga arbitrariteti (shih *mutatis mutandis* Kërkesa nr. 53363/99, Vanek kundër Republikës Sllovaqe, Vendimi i GJEDNJ të 31 majit 2005).

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në përputhje me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 11 korrik 2012, njëzëri:

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim to ti komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në përputhje me nenin 20 (4) të Ligjit;
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. Dr. Enver Hasani

